

## Kalimi nga niveli primar – në nivelin sekondar I

Shkollimi i obligueshëm në Zvicër zgjatë 11 vjet. Shkollimi i obligueshëm ndahet në nivelin primar (përfshirë 2 vjet në kopsht të fëmijëve/niveli hyrës) dhe niveli sekondar I. Në lidhje me procedurat e kalimit nga niveli primar në atë sekondar I, në shumicën e shkollave prindërit informohen nga mësimdhënësit ose zyrtarët në klasën e fundit të shkollës fillore.

### Kapaciteti i performancës

Me rastin e kalimit nga niveli primar në nivelin sekondar I për përcaktim të niveleve të ndryshme, vendimtare është kapaciteti i performancës së fëmijës. Në pjesën gjermano-folëse të Zvicrës ekzistojnë të ashtuquajturat gjimnaze afatgjate, që mund të ndiqen pas mbarimit të shkollës fillore. Për të kaluar në këtë ofertë shumë nxënës/e marrin pjesë në kurse përgatitore, sepse duhet të kalohen procedurat e pranimit. Në disa vende këto kurse ofrohen prej shkollave të komunës, në vende të tjera ekzistojnë oferta private me pagesë.

### Përkrahja

Mësuesi/ja i/e klasës së fëmijës tuaj është personi i parë për këshillim dhe mund t'ju informojë mbi mundësitë shtesë të mbështetjes brenda komunës. Mbështetje mund të ofrojë edhe ndonjë organizatë nga rrethi juaj kulturor. Rrjeti për Migrantët (Web for Migrants – [www.migraweb.ch](http://www.migraweb.ch)) është një organizatë jo fitimprurëse, politikisht dhe në aspektin fetar e pavarur. Në faqen e internetit të kësaj organizate [www.migraweb.ch](http://www.migraweb.ch) në shumë gjuhë të ndryshme gjeni (përveç shumë informacioneve të tjera të dobishme) të radhitura edhe nyje (linqe) të organizatave të ndryshme të huaja.